

20262123327

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË REGJISTRIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM SOCIAL

Neni 1

Në Ligjin për Regjistrin e sigurimit shoqëror të detyrueshëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 209/23 dhe 13/26), neni 13 ndryshohet si vijon:

„(1) Me punën e Drejtorisë udhëheq drejtori, të cilin e emëron dhe e shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Qeveria), me propozim të ministrit me mandat prej pesë vjetësh dhe me të drejtë për edhe një zgjedhje të njëpasnjëshme.

(2) Drejtori emërohet në procedurë të hapur, të drejtë dhe transparente në të cilën zgjidhet kandidati më i mirë i cili i plotëson kushtet.

(3) Për emërimin e drejtorit zhvillohet procedurë në përputhje me Ligjin për drejtues të lartë.

(4) Drejtori për punën e tij dhe për punën e Drejtorisë është përgjegjës para Qeverisë dhe para ministrit.

(5) Për drejtor mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet për emërim të drejtorit të përcaktuara me Ligjin për drejtues të lartë.

(6) Drejtori me vendim është i detyruar të autorizojë një zyrtar administrativ udhëheqës i cili e zëvendëson në rast të mungesës së tij.

(7) Zyrtari administrativ udhëheqës i autorizuar nga paragrafi (6) i këtij neni e udhëheq punën e rrjedhshme të Drejtorisë në rast të mungesës së drejtorit.“.

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si vijon:

„(1) Drejtorit të Drejtorisë i skadon mandati me skadimin e mandatit, ndërsa para skadimit të mandatit shkarkohet dhe mandati i skadon sipas fuqisë së ligjit në përputhje me Ligjin e Udhëheqësve të Lartë.

(2) Përveç rasteve sipas paragrafit (1) të këtij neni, drejtori i Drejtorisë mund të shkarkohet edhe nëse nuk miratohet raporti gjashtëmujor ose vjetor për punën e Drejtorisë për shkak të qëllimeve të parealizuar të përcaktuara në planin vjetor të punës sipas nenit 10 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Qeveria mund ta shkarkojë drejtorin e Drejtorisë para skadimit të mandatit me iniciativë të saj ose me propozim të ministrit, në përputhje me Ligjin e Udhëheqësve të Lartë.

(4) Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit ose për shkak të shkarkimit të drejtorit, Qeveria nëse nuk është emëruar drejtor i ri, emëron ushtrues detyre të drejtorit në pajtim me Ligjin e Udhëheqësve të Lartë, për një periudhë deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj.“.

Neni 3

Drejtori i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon ta kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga botimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërkaq do të fillojë të zbatohet nga 1 tetori i vitit 2026.